




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>DPK</u> Nr. I faq. Broj stranica Nr. pages <u>04</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>03-02/230/17</u> Prot No. Data Datum <u>02-02-2017</u> Date PRISHTINË



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 01.02.2017, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-4693-16, për Zyrtarin e lartë z.Dejan Vasiç-Këshilltar në Komunën e Zveçanit, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nën dyshimin për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me Nr. AKK-03-02-4693/16, për Zyrtarin e lartë, z.Dejan Vasiç-Këshilltar Komunal në Zveçan, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznes privat, është trajtuar sipas procedurave të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Fillimisht, Agjencia kundër Korrupsionit ka bërë shkresë njoftuese zyrtarit të lartë z.Dejan Vasiç (DPK-03-02-4776-16), dhe pastaj ai ka kontaktuar Agjencinë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Vasiç është deklaruar se brenda afatit do t'i bëjë ndryshimet e nevojshme në biznes për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka dërguar ndryshimet në biznes (DPK/Dpki-03-02/200/17) të bëra në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilin shihet se, z.Dejan Vasiç tashmë ka hequr dorë nga drejta e të qenurit person i autorizuar në biznes privat, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtore Agjencisë kundër Korrupsionit

  
/ Shaip Havoli





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI – CORRUPTION AGENCY**

---

U skladu sa članom 11 (stav 1.1), članom 5 (stav 1, tačka 1.5), članom 18 (stav 10 i 11) Zakona br. 03/L-159 za Agenciju protiv Korupcije, kao i sa članom 19 (stav 11) Pravilnika br. 01/2014 o Radu Agencije protiv Korupcije, Direktor Agencije protiv Korupcije, dana 01.02.2017 doneo je:

**ODLUKU**

**I. Zatvara se slučaj br. AKK-03-02-4693-16, za Visokog Zvaničnika g. Dejana Vasića – Savetnik u Opštini Zvečan, zato što je izbegnuta situacija sukoba interesa u vršenju javne funkcije.**

**II. Slučaj se može obnoviti u svako doba ukoliko se pojavljuju nove okolnosti.**

**O b r a z l o ž e n j e**

I. Slučaj je otvoren pod osnovanom sumnjom o Sukobu interesa u toku vršenja javne funkcije, pod sumnjom o Sukobu interesa u toku vršenja javne funkcije, br. AKK-03-02-4693/16 za Visokog Zvaničnika, g. Dejana Vasića – Savetnik Opštine u Zvečanu, i istovremeno ovlašćeno lice u privatnom biznisu, tretiran je prema predviđenoj proceduri Zakona za Sprečavanje sukoba interesa u toku vršenja javne funkcije.

Agencija protiv Korupcije je prvo, službenim pismom upoznala visokog zvaničnika g. Dejana Vasića (DPK-03-02-4776-16), i posle toga on je kontaktirao Agenciju protiv Korupcije, s kojim slučajem je upoznat sa situacijom u kojoj se nalazio, kao i sa izmenama koje treba izvršiti da bi izbegnuo situaciju sukoba interesa u vršenju svoje javne funkcije.

Visoki zvaničnik, g. Vasić je izjavio da će u roku izvršiti potrebne izmene u biznisu, da bi izbegao situaciju sukoba interesa u vršenju svoje javne funkcije.

U međuvremenu, on je u Agenciju protiv Korupcije dostavio izmene u biznisu (DPK/Dpki-03-02/200/17) iz Kosovske Agencije za Registraciju Biznisa (ARBK) na kojem se potvrđuje da g. Dejan Vasić sada je odustao od prava ovlašćenog lica u privatnom biznisu, u ovom slučaju je izbegao situaciju sukoba interesa u vršenju svoje javne funkcije.

II. U skladu sa članom 18, (stav11) Zakona br. 03/L-159 za Agenciju protiv Korupcije, Agencija može u svako doba ponovo otvoriti slučaj ukoliko sa jave nove okolnosti.

S'toga je odlučeno kao u dispozitivu ovog rešenja.

Rešenje se dostavlja:

- Visokom javnom zvaničniku
- Direktor DPK
- g./g-đi. (odgovornom službeniku)

Direktor Agencije protiv Korupcije



*Shaip Havolli*  
/ Shaip Havolli /